VENDIM
Nr. 179, datë 4.11.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA PËR SHTYRJE TË AFATIT TË VENDIMMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/4 prot., datë 27.10.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Pas kërkesave të përsëritura të aplikuesit për zgjatjen e afatit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim, ERE, me vendimet nr. 43, datë 6.3.2020, dhe nr. 119, datë 17.7.2020, së fundmi, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.
- Ndërkohë, përpara përfundimit të këtij afati, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka paraqitur shkresën me nr. 1103 prot., protokolluar në ERE, në datën 12.10.2020, duke kërkuar sërish shtyrjen e këtij afati procedural.
- Kërkesa e "Albgaz" sh.a. rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:
- Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.
- Me anë të kësaj kërkese, shoqëria kërkon miratimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale për operimin e hapësirave të depozitimit të gazit natyror për "Albgaz" sh.a., deri në datën 20.3.2021, për arsye që lidhen me gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19, e cila ka krijuar vështirësi në përmbushjen e dokumentacionit të munguar, për shkak të kufizimeve që vazhdojnë ende dhe që vështirësojnë punën e "Albgaz" sh.a.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a., për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.3.2021.
2. Shoqëria "Albgaz" sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 10.3.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 10.10.2020.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti